

Syllabusi i lëndës

Lënda: Fik`h Ibadat - I -

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 102

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2024-2025

Semestri: i -I-rë

Mësimdhënësi: Dr. Ilmije Kuqi

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Fikhu është shkenca e dispozitave ligjore brenda sistemit juridik islam, nëpërmjet të cilit në fenë islame rregullohet çdo sferë e jetës private dhe publike. Kjo lëndë konsiderohet ndër lëndët kryesore dhe përfshin shtyllat kryesore të Islamit si pastërtia, namazi, zeqati, agjërimi dhe haxhi. Mirëpo ne, në këtë lëndë shtjellojmë në detaje vetëm kapitullin e pastërtisë dhe të namazit, në mënyrë që ato të kryhen në formën që kërkon Kur`ani dhe Suneti.

Qëllimi i lëndës

- Forcimi i marrëdhënieve të studentit me Krijuesin e tij me anë të mësimin të rregullave të adhurimit.
- Njohja e rëndësisë së anës praktike të fesë të cilën e përfaqësojnë ibadetet, të cilat janë pjesë plotësuese të besimit.
- Njohja e ibadeteve, normave dhe kushteve të saj dhe çdo gjë çka ka të bëjë me te, e që studenti të jetë i avancuar në fenë e tij dhe i vetëdijshëm për normat e tij.
- Përmirësimin e moralit si dhe përfitimin e virtyteve të larta, si: bindja, rregullimi i jetës, pastërtia, durimi, dhembshuria ndaj të tjerëve etj.
- Lidhja e studentit me burimet doktrinare, si dhe përfitimi i tij nga ato.
- Angazhimi i mendjeve për njohjen - nxjerrjen e normave të Legjislacionit Islam nga Kur`ani dhe Suneti.
- Arritja e të kuptuarit të qëllimit të Legjislacionit Islam në adhurim.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje:

- Të përshkruaj arritjen e njohjes së dispozitave praktike të Legjislacionit Islam.
- Të krahasoj ndërmjet dispozitave praktike që kanë të bëjnë me veprat e të ngarkuarve në obligimet fetare dhe atyre jo praktike.
- Të diskutoj rreth mendimeve të ndryshme të dijetareve për ndonjë çështje të shtjelluar.
- Të mbroj mendimin e tij me argumente të sakta dhe bindëse.
- Të prezantoj mendimin bazues dhe përfundimtarë të medhhebit të tij.
- Të jetë në gjendje që njohurit e përfituara gjatë periudhës studentore t'i praktikojë në jetën e përditshme.

Metodologjia e mësimdhënies:

Procesi i mësimdhënies arrin statusin e ligjëratave përsëritjeve, nxitjen e studentëve për diskutime dhe analiza në kuadër të ligjërates duke mos i përjashtuar punimet seminarike semestrale.

Raportet student-profesor janë të hapura në mënyrë që studenti të jetë më afër udhëtimeve për arritjen e rezultateve dhe suksesit.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjërata
1.	I	Njoftim i përgjithshëm me lëndën, literaturën, vlerësimin e studentëve, etj, si dhe tema: Abdesi.
2.	II	Gusli dhe tejemumi,
3.	III	Mes'hi mbi meste dhe mbi fashë.
4.	IV	Hajdi, nifasi dhe istihada.
5.	V	Namazi dhe kohët e tij.
6.	VI	Kushtet e namazit dhe vaxhibet e tij.
7.	VII	Sunetet e namazit dhe namazi me xhemat.
8.	VIII	Gjërat që e prishin namazin
9.	IX	Mekruhet e namazit.
10.	X	Namazi i vitrit dhe i nafileve.
11.	XI	Namazi i teravive dhe namazi kaze.
12.	XII	Sehvi sexhdeja dhe sexhdetu tilaveti.
13.	XIII	Namazi i të sëmurit dhe i udhëtarit.
14.	XIV	Namazi i xhumasë dhe i bajrameve.

15.	XV	Namazi i xhenazes.
-----	----	--------------------

Provimi përfundimtar

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 10%

Testi intermedier 40%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e parapara:

- të respektojë orarin e ligjëratave;
- të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi;
- të mos mbajë të kyçur celular, apo aparate tjera gjatë orëve të mësimi.

Literatura obliguese:

1. Margaritari në detin e Fikhu Ibadatit, Ilmije Kuqi, Prishtinë 2021.
2. Fik'hu Hanefi, Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Zurch 2011.
3. Bedai es-Senai, Ebu Bekr bin Mesud el-Kasani, Kairo 2005.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Çështjet e Fikhut sipas Kuduriut, Muhamed Ashik Ilahi el – Bureni, Prishtinë 2002.
2. Fik'hu el-Hanefi el-Mujessir, Vehbe ez-Zuhejli, darul-fikr 2010.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45

Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktme me mësimdhënësin\konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	1	10	10
Detyra të shtëpisë	1	20	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	30	30
Përgatitja përfundimtare për provim.	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	5	10
Totali	16	15 javë	175